

LUTJA E SHKRIMTARËVE

(Refleksion)

Zoti në Shqipëri, tashmë, është i dëshiruar e i respektuar për çdo besimtar e për çdo zemër shqiptari. Shqipëria, vend i banuar kryesisht prej muslimanëve, ushtron në liri të plotë tri besime fetare, që janë në harmoni të përkryer me njëri-tjetri, duke qenë për mbarë religionin një shembull harmonie e bashkëjetese. Bota, në tërësi, siç shprehet shkrimtari ynë Faik Konica, e njih këtë vend nëpërmjet këtyre myslimanëve dhe kulturës së tyre islame. Zotin, shqiptarët, si rrallë ndonjë popull në botë, e kanë të pranishëm edhe në Himnin Kombëtar. Gjë solemne kjo që, kur betohemi mbi flamurin kombëtar me vargjet e Asdrenit, këndojmë: “Se Zoti vetë e tha me gojë, që kombet shuhen përmbi dhe, por Shqipëria do të rrojë...”

Pra Zoti vetë e ka bekuar këtë tokë të lashtë, Allahu e ka gatuar dhe e ruan me Dorën e Tij. Jemi dëshmitarë për historinë tonë dhe për fatin e bardhë që do t'i buzëqeshë Kosovës. Shkrimtarët shqiptarë, përpara se të drejtonin mesazhet shpirtërore dhe të kultivonin veprat e tyre letrare, i janë drejtuar Krijuesit, Fuqiplotit dhe Mëshiruesit të madh. Poeti ynë kombëtar Naim Frashëri, në Ligën e përjetshme të shqiptarëve thotë fjalët e shpirtit: “Kemi besë Perëndinë, mëmë e atë Shqipërinë. Në lutjet drejtuar Zotit, Naimi, gjen shpresën vetëm tek i madhi Zot: “Kam shumë shpresë tek Perëndia / Që të mos mbesë kështu Shqipëria / Po të ndritohet, të lulëzohet.” Gjuhën shqipe, ai e quan “gjuhë perëndie”. Mbrothësinë e Shqipërisë, ky mëmëdhetar i madh, e sheh te Zoti, të cilit i drejtohet: “Begatoje, o imzot ti këtë vend / fali dritë, dashuri, fali shend.” Në vargje ai drejton lutje që rrallëkush do t'i thurte aq bukur e bindshëm: “Zot! Fali Shqipërisë dhe shqiptarëve / që i falen emrit tënd / gjithë të mirat në jetë / dhe mërgoji nga të ligatë”. Vepra naimjane ka në brendësi mesazhe, ide, simbole hyjnore të frymëzuara nga Kurani. Siç pohon Ali

M. Basha në librin “Islami gjatë shekujve në Shqipëri” (Tiranë 2000), Naimi në veprën “Mësime”, Bukuresht 1894, ka përkthyer 17 faqe nga Kurani dhe në kapitullin “Thelb i Kuranit”, ai lutet për Zotin: “I verbëri s’mund të shohë / i dituri s’mund ta njohë”. “Perëndia, e Drejta, Kombi, Gjuha, Shqipëria, Shqiptaria! Ja qëllimi ynë!” Janë fjalët e fundit të Sami Frashërit në kryeveprën e tij për Atdheun. Secili njeri është peng i veprës së vet, shkruhet në Kur’an.(74-38) Gjej më të mirin rast të perifrazoj një argument (ajet) prej të Ndriturit Libër: “Nun, betohem në pendën dhe atë çka Na shkruajnë”(Kurani 68:1). Duke mos qenë idhujtar, përveç dashurisë së zjarrtë për mëmëdheun e mëmëdhetarët, në panteizmin e tij më tepër se Zoti i shkrirë në gjithçka, qëndron ideja: Zoti krijues i gjithçkaje. Le të gjykohen në kahun që kanë si mesazhe, vargjet: “Ç’sheh, është Zot i vërtetë / Ç’dëgjon është zëri i tija / Gjithë ç’ka e s’ka në jetë është vetë Perëndia”. Ndonjëherë poetët keqkuptohen. Vargu i tyre objektivisht mund të shprehë aq pak, e subjektivisht shumëçka. Në të dy rastet Naimi është i mirëkuptuar.

Edhe Faik Konica, kalorësi i gjuhës sonë, princi i letërsisë dhe i kulturës shqiptare, para se të përpilojë epistolare, i drejton Zotit “Lutjen e shkrimtarit”, duke e thirrur: “Zoti ynë që je në qiell, na jep fuqi të mbyllim gojën kur s’kemi gjë për të thënë”. Konica i mençur e kishte të qartë se ç’ishte fuqia me diturinë. Është ndoshta vendi të perifrazoj një thënie të Montenjtit, filozof e eseist francez: “Dija pa vetëdije, është rrënim i shpirtit”. Kurse në Japoni, për edukimin e fëmijëve, pedagogjia dhe sociologjia e këtij vendi tepër të zhvilluar thonë se edukimi i fëmijës fillon njëzet vjet para se të lindë. Hidhemi në astronomi. Shkenca, e cila nuk përcakton ende formësinë, gravitacionin dhe qëndresën e lëmshit të dheut, vërente një lëvizje sipërfaqësore valore të masave ujore. Në Kur’an flitet për një lëvizje të fuqishme të valëve, çka për vite e vite shkenca me qesëndi e hidhte poshtë këtë fenomen të përhershëm. Tashmë, vetë shkenca, me anën e satelitëve ka fotografuar dhe e pohon një lëvizje të tillë. Këtë lëvizje nënvalore, të pohuar në Kur’an, e vëren edhe liriku i famshëm shqiptar Poradeci, në poezitë e liqenit. Ai i shihte valët nënujore, tek dremiste liqeni i kaltër, mbi zall të pyllit vjeshtarak. Liqeni pa kufij, që përflakej ndaj fundesh, ndizet e vetëtinte, kur yll i ditës perëndonte në qetësi e dashuri. Poeti,

atje gjen vargun, atje merr frymën, atje çon shpirtin, gjer m'u në gji, gjer m'u në fund, ku ndodhej fuqia madhështore e Zotit që ndryste gjithçka...

Zotit i janë lutur e i janë falur pothuajse tërë shkrimtarët shqiptarë. Fishta e fillon "Lahutën e Malcisë", kryeveprën e eposit tonë, me vargun: "Ndhimo Zot, si më ke ndihmue!" Zoti vërtet e ndihmoi, teksa kjo vepër e tij mbeti Iliada shqiptare, se në të flitej veç me zërin e Zotit. Poeti, me këtë enciklopedi epike shumëdimensionale, aludon qartë se liria është sakrificë dhe besim. Është më se i tepërt komenti i vargut: "Zoti në qiell e në tokë, në faqet e Lahutës."

Edhe V. Prenushi, me romancën "Amë e bi", kushtuar flamurit kombëtar, betohet me fjalët e Zotit: "Pash at diell e pash at hanë / Pash at Zot që kthjell e vranë". Zotit do t'i falej edhe poeti Bilal Xhaferi, i arratisur prej diktaturës komuniste në Amerikë, që Zoti do t'i sillte në Shqipëri eshtrat e tij, në vitet e demokracisë, për t'u prehur pranë njeriut të gjakut të tij, dijetarit Hoxha Tahsin. Lutje do t'i bënin Atij edhe Arshi Pipa, Sejfullah Malëshova, Petro Marko, Pjetër Arbnori, At Zef Pëllumbi e dhjetëra shkrimtarë antologjikë. Duke sjellë një prozë konvencionale e moderne, si në stil e në ligjërim, dhe, duke prurë mesazhe spirituale tërësore në depërtime filozofike, edhe shkrimtari i madh I. Kadare i ofron veprës herë-herë konstruksione të tilla: "...pas asaj dore fshihej një dorë tjetër dhe, pas asaj tjetrës, dora e madhe e Zotit." I. Kadare, "Pasardhësi", Tiranë, 2003.

Lutja e shkrimtarëve është zë qiellor edhe në letërsinë botërore. Shkrimtarë të mëdhenj botërorë të çdo drejtimi letrar dhe çdo periudhë krijimi, gjetën si mbështetje të veprave artistike. Veç anës humane që ato përcillnin, edhe tolerancën, çka e gjetën në mësimet e fesë dhe veçanërisht në Kur'an, ku shkruhej: "Ju keni fenë tuaj e unë kam fenë time" (Kurani 109:6). Ose mesazhe të tjera universale prej tij, si "Allahu nuk e ndryshon një popull, derisa ai nuk e ndryshon vetveten". (Kurani 13:11). Fjalët e Profetit Muhamed: "...dituria është mik në shkretëtirë, shok në vetmi, prijës në fat, ndihmës në vuajtje..." u ofroi atyre atë hapësirë, tek e cila koha i pengonte të shëtisnin. Frymëzime të tilla të thella apo apel diturisë i bën Dante në "Komedia Hyjnore", duke mbështetur mendime të Kuranit apo Miraxhit, ngritjes në qiell të

Muhamedit. Ide orientale shërbyen për romanin “Don Kishoti” të Servantesit, “Robinson Kruzo” të Daniel Defosë. Si Dantja do të vepronte Shekspiri, Tolstoi, Gëte dhe Shileri. I pari do të krijonte latinishten zyrtare, i dyti anglishten e folur me gjuhën e Shekspirit, dy gjermanët e mëdhenj – gjermanishten e re. Për kryeveprën e vet “Komedia Hyjnore”, poeti italian D. Aligeri mori burim të drejtpërdrejtë “Librin e Muhamedit”, tekst arab mjaft i njohur i vitit 1264. Prej andej ky poet ka marrë Frymën, Fjalën, Rrathët qiellorë. Kurani, në ajetet e tij, thotë se njerëzit që nuk besojnë, vazhdojnë të humbasin kohën e vërtetë. Shkrimtari modernist Marsel Prust, që ndërpreu traditën letrare dhe bëri bujë në veprën disavëllimëshe “ Në kërkim të kohës së humbur”, ka marrë jo pak prej Kuranit. Them se jam poet, por këshillat që po rendis nga ky Libër, janë vargjet më të jashtëzakonshme:

“ Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)
Krijoi njeriun prej gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës)
Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që mësoi (njeriun) të shkruajë
me pendë... (Kuran 96:1-5)

Mund të përmbyll këta rreshta me fjalët e poetit të shquar amerikan Robert Farst: O Zot, ma vër veshin!

Literatura e shfrytëzuar:

1. Kurani i madhërishëm. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam. Tiranë, 2006
2. Robert ELSIE “Histori e Letërsisë shqiptare”, Tiranë-Pejë 1997
3. Gazetarë dhe publicistë shqiptarë. Fjalor enciklopedik, Tiranë, 2005
4. Shefik Osmani “Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë”, Tiranë, 1998
5. Gazmend Shpuza “Bota iraniane në veprën e Sami Frashërit”, Tiranë, 2004
6. Faik Konica. Vepra I. Rilindja- Prishtinë, 1997
7. I. Kadare “Pasardhësi”, Tiranë, 2003
8. Fatmir S. Baçi “Arti dhe besimi te Zoti” ese. Tiranë, 1999
9. Ali M. Basha “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”, Tiranë, 2000